

Ligjërata 9

PARAJA DHE SISTEMI BANKAR

⇒ Në këtë kapitull do të njiheni me:

- *Konceptin e parasë*
- *Funksionet e parasë*
- *Komponentet e ofertës monetare*
- *Ofertën dhe kërkesën për para*
- *Lidhja në mes të ofertës monetare dhe normës së interesit*
- *Bankat, llojet dhe procesi i krijimit të parasë*

KONCEPTI I PARASË: HYRJE

- ➔ Paraja është element i rëndësishëm në analizat ekonomike
 - ➔ Efektet në variablat e tjerë ekonomik (normë interesi, çmime etj.)
- ➔ **DEFINIMI I PARASË:**
 - Çdo objekt standard dhe përgjithësisht i pranuar që përdoret si mjet këmbimi ose pagese.
- ➔ **ZANAFILLA E PARASË:**
 - Njerëzit fillimisht kanë konsumuar atë që kanë prodhuar
 - Rritja e volumit të mallrave të prodhuara => akumulimi, pronësia
 - Këmbimi mall – mall (tramba)
 - Por, specializimi i punës ka sjellur problemet e këmbimit
 - Koincidenca e dyfishtë - përputhja e plotë për llojin dhe sasinë e mallrave që duan të këmben dy prodhues
 - Problemet rreth gjetjes së vlerës së njëjtë
 - Zgjidhja e problemit: Përdorimi i një malli të caktuar si mjet këmbimi
 - Rolin e parasë e kanë luajtur: bagëtia, bakri deri tek ari e argjendi

...KONCEPTI I PARASË: HYRJE

➔ KARAKTERISTIKAT E PARASË

Që një mall i caktuar të përdoret si para ai duhet ti gëzoj disa veti:

- Të jetë i transportueshëm
- Të jetë i ruajtshëm
- Të jetë i ndashëm në pjesë të vogla
- I sigurt nga falsifikimi

➔ PARAJA LETËR

- Zëvendësuese e parasë mall
- Zanafilla (historiku)
- Mbulesa në ari
- Fillimisht, para ishte ari, ndërsa paraja letër ishte vetëm dëshmi
- Ndërhyrja e një autoriteti (shteti) - para e dekretuar
- Paraja letër nuk ka përdorim alternativ përpos si mjet këmbimi

➔ PARAJA BANKARE OSE ÇEÇET BANKARE

- Rritja e vëllimit të ekonomisë e bënë paranë letër të kushtueshme
- Paraqiten çeçet bankare
- Shërbejnë si mjet këmbimi apo pagese dhe mund të shëndrrohen në para

FUNKSIONET E PARASË

➔ FUNKSIONI SI MJET KËMBIMI

➔ Është funksioni kryesor i parasë.

➔ Lehtëson funksionimin e ekonomisë, duke i realizuar transaksionet me kosto shumë më të ulët

➔ FUNKSIONI SI MJET LLOGARIE (MATËSE E VLERËS)

➔ Përmes çmimeve, shërben si njësi matëse e vlerës së produkteve

➔ Të gjitha mallrat shprehen në një emërues të përbashkët (çmimin)

➔ FUNKSIONI SI MJET KURSIMI (RUAJTËSE E VLERËS)

➔ Ruajtëse e vlerës ose mjet kursimi, sikur edhe format tjera të pasurisë (aksionet, obligacionet, pasuria etj.)

KOMPONENTËT E OFERTËS MONETARE

- ➔ Masa monetare është shumë e rëndësishme në dizajnimin e politikave makroekonomike
 - ➔ Norma e interesit e bankës qendrore
 - ➔ ndikimi në nivelin e investimeve
 - ➔ Blera dhe shitja e letrave me vlerë
- ➔ Matja e saktë e masës monetare është një problem që përcillet me
 - ➔ vështirësi teorike (si ta definojmë paranë)
 - ➔ Praktike (si ta masim)
- ➔ Oferta monetare llogaritet si shumë e instrumenteve të ndryshëm që në një shkallë të caktuar shërbejnë si para
- ➔ Oferta monetare shprehet nëpërmjet disa komponentëve që quhen **agregatë monetarë** të cilët kanë në themel një kriter të përbashkët llogaritje

KOMPONENTËT E OFERTËS MONETARE

➔ Agregatë monetarë:

M1: paraja e transaksioneve -

- ➔ monedhat (plotësisht likuide) dhe
- ➔ ato që shumë shpejt kthehen në para (llogaritë çekueshme, çeket e udhëtarëve, etj.)


M2: paraja e gjerë –

- ➔ përfshin M1 dhe format tjera që nuk janë para transaksionesh por që mund të shëndrrohen shpejt në para (depozitat afatshkurtra).
- ➔ Kjo është masa më e saktë e ofertës monetare.
- ➔ Përdoret gjërësisht në analiza të ofertës monetare

M3: përfshin M2 dhe agregatët monetar më pak likuid (depozitat afatgjatë)

L: përfshin M3 dhe aktivet tjera që kanë tipare likuiditeti (bonot e thesarit)

...KOMPONENTËT E OFERTËS MONETARE



- Agregatët monetarë klasifikohen në bazë të shkallës së likuiditetit
- Kur flasim për para zakonisht i referohemi agregatit monetar M2
- Me kalimin e kohës bëhet kalimi nga një agregat në tjetrin

KËRKESA PËR PARA

Kërkesa për para => pse njerësit mbajnë para?

- ➔ Kërkesa për para e ka bazën tek funksioni që kryen paraja
 - ➔ Njerëzit mbajnë para për të kryer transaksione
- ➔ Por, mbajtja e parasë ka kosto (heqje dorë nga investimi)
 - Interesi (shembull: depozitimi në banka i 1000 Euro kur $i=10\%$)

KËRKESA PËR PARA

⇒ Motivet e mbajtjes së parasë

⇒ Motivi 1: Kërkesa për transaksione - për të blerë mallra dhe shërbime (individët) dhe për pagesën e faktorëve të prodhimit (firmat). Kjo kërkesë varet nga:

→ Niveli i GNP - rritja e GNP real do të thotë rritja e vëllimit të mallrave dhe shërbimeve që tregtohen. Kjo do të thotë që rriten edhe sasia e parasë që duhet për të realizuar këmbimin e tyre

→ Niveli i çmimeve – kur rriten çmimet është e nevojshme të rritet edhe sasia e parasë që duhet për të realizuar këmbimin e të njëjtës sasi mallrash dhe shërbimesh

→ Niveli i normës së interesit - me rritjes e normës së interesit kërkesa për para transaksionesh (apo mbajtja e parasë në dorë) bie, sepse kjo rrit koston e mbajtjes së parasë, prandaj do të kemi tendencën për të ulur sasinë e parasë që mbahet për transaksione.

KËRKESA PËR PARA

➔ Motivi 2: ruajtja e vlerës (kursimi)

➔ Teoria e portofolit –

- ➔ njerëzit dëshirojnë që pasurinë e tyre ta mbajnë në formën që sjell të ardhura sa më të mëdha
- ➔ por, ata nuk dëshirojnë të bëjnë investime me shkallë të lartë rreziku.
- ➔ Kjo teori thotë që njerëzit bëjnë kombinimin e formave të ndryshme të pasurisë (në para dhe në obligacione) ashtu që të minimizohet rreziku
- ➔ Aktiveve mund tju ndryshojë çmimi por jo parasë

BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

- **Mbajtja e parasë ka kosto (interesi i humbur)**
- **Ka persona që kanë para dhe persona që dëshirojnë të investojnë**
- **Kjo kontradiktë zgjidhet ashtu që ata që kursejnë u japin hua atyre që dëshirojnë të investojnë**
- **Sigurimi i informacioneve ka kosto (kush ka para dhe kush dëshiron të investoj) Kështu lind nevoja e krijimit të institucioneve financiare (bankave)**
- **Bankat: janë firma financiare të themeluara për fitim njësoj si firmat tjera**
- **Aktivitetet kryesore të bankave:**
 - **Pranimi i depozitave (në të parë dhe të afatizuara) ku banka i paguan interes depozituesit**
 - **Dhënien e kredive ku bankës duhet paguar interes**
- **Fitimi i bankave = norma e interesit të kredive – norma e interesit të depozitave**

BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

- ➔ Niveli i kredive të lëshuara determinohet nga norma e interesit dhe shkalla e rrezikut
- ➔ Lidhja në mes të nivelit të rrezikut dhe normës së interesit është pozitive
- ➔ Vëllimi i kredive kufizohet edhe nga nevoja për të përmbushur kërkesat për likuiditet për të përballuar tërheqjen e depozitave
- ➔ Banka qendrore vendos një normë të detyrueshme për depozitat:
 - ➔ norma e rezervave të detyrueshme: % e depozitave që duhet të mbahen në bankë (që nuk mund të jepen kredi)
 - ➔ Kjo e mbron bankën nga falimentimi në rast të tërheqjes të parave mbi mesatare

...BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

- ➔ Aktiviteti bankar (marrja e depozitave dhe dhënja e kredive/huave)
- ➔ Aktivitet dhe pasivet

Tabela 21.1: Bilanci i thjeshtë i bankës

AKTIVE		PASIVE	
Rezervat	100	Depozitat e çekueshme	1000
Huatë	4000	Depozitat e kursimeve dhe me afat	2800
Letrat me vlerë	1800	Pasivet tjera	2100
Totali	5900	Totali	5900

Shënim:

- ➔ Rezervat nuk jepen hua
- ➔ Mundësia e bankës për të dhënë hua përbën bazën e **shumëfishimit të parasë**
- ➔ Banka jep hua pasi jo të gjitha depozitat tërheqen në të njëjtën kohë

...BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

- Procesi i shumëfishimit të parasë
- Është injektuar një sasi monetare në ekonomi
 - Supozojmë që znj. Ermira ka shitur një bono thesari qeverisë dhe ka marrë mjete financiare prej 2000 të cilat i ka depozituar në Bankën A
 - Si rezultat rritet $M1 = 2000\text{€}$

Shembull: Bilanci i Bankës A

AKTIVE		PASIVE	
Rezervat	2000	Depozitat	2000
Totali	2000	Totali	2000

...BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

POR, Banka A mund të japë hua, dhe nëse themi se norma e rezervës së detyrueshme = 10%, Banka A mund të japë 1800 €

Bilanci i Bankës A pas kësaj është:

AKTIVE		PASIVE	
Rezervat	200	Depozita	2000
Hua	1800		
Totali	2000	Totali	2000

➔ Me këtë rast, M1 rritet edhe për 1800 €.

➔ Pra: $M1 = 2000€ + 1800€ = 3800€$

SUPOZOJMË se pjesa prej 1800€ e dhënë hua depozitohet në Bankën B nga huamarrësi apo shitësi

Bilanci i Bankës B do të jetë:

AKTIVE		PASIVE	
Rezervat	1800	Depozita	1800
Totali	1800	Totali	1800

...BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

Nëse norma e rezervës së detyrueshme = 10%, Banka B mund të japë 1620 € hua

Bilanci i Bankës B pas kësaj është:

AKTIVE		PASIVE	
Rezervat	180	Depozita	1800
Hua	1620		
Totali	1800	Totali	1800

Me këtë rast, M1 rritet edhe për 1620 €.

Pra: $M1 = 2000€ + 1800€ + 1620€$

Ky proces vazhdon derisa rezervat të bien në zero:

Bankat	Depozitat	Huatë	Rezervat
Banka A	2000	1800	200
Banka B	1800	1620	180
Banka C	1620	1458	162
Banka D	1458	1312.2	145.8
...
Totali në sistemin bankar	20 000	18 000	2 000

Në këtë rast, M1 rritet vetëm me 20,000 €

Në fund të procesit: shtesa në rezervat e detyrueshme në sistemin bankar është e barabartë me shtesën fillestare të deppozitave

...BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

⇒ Duke ditur r =norma e rezervës së detyrueshme, mund të shkruajmë:

$$\Delta D \cdot r = \Delta R$$

⇒ Nga këtu nxjerrim se: $\Delta D = \Delta R / r$ ose $\Delta D = (1 / r) * \Delta R$

⇒ Në rastin tonë kemi:

$$\Delta D = (1 / r) * \Delta R = (1/0.1) * 2,000 = 20,000$$

⇒ Raporti $1/r$ tregon sa shumëfishohet shtesa fillestare e rezervave në sistemin bankar nëpërmes mekanizmit të dhënies së huave

⇒ Ky quhet multiplikatori i ofertës monetare:

Legjenda:

ΔD = shtesa në depozite

r = norma e rezervës së detyrueshme

ΔR = shtesa në rezerva të detyrueshme

...BANKAT, LLOJET DHE PROCESI I KRIJIMIT TË PARASË

Në praktikë mund të mos veprojë multiplikatori → oferta monetare nuk rritet si rezultat i rritjes së rezervave fillestare

Dy arsye:

- 1) Huamarrësi nuk i depoziton paratë
 - Varesisht në cilën hallkë të zingjirit ndalet procesi i shumëfishimit të parave
 - Sa më shumë para që mbahen në dorë, oferta monetare rritet më pak
- 2) Bankat mund të mbajnë rezerva të tepërta

Nëse rritet norma e rezervës së detyrueshme, atëherë rritja e M1 është më vogël:
Shembull: $r=20\%$

Bankat	Depozitat	Huatë	Rezervat
Banka A	2000	1600	400
Banka B	1600	1280	320
Banka C	1280	1024	256
Banka D	1024	819	205
...
Totali në sistemin bankar	10 000	8 000	2 000

Në këtë rast, M1 rritet vetëm me 10,000 €

Pyetje për diskutim

- ⇒ Funkcionet e parasë
- ⇒ Motivet për mbajtjen e parasë
- ⇒ Definoni agregatët monetar: M1, M2, M3 dhe L
- ⇒ Si bëhet shumëfishimi i parasë?
 - ⇒ A kemi shumëfishim të parasë nëse BQ vendos që $r=100\%$
- ⇒ Çfarë paraqet multiplikatori i ofertës monetare
- ⇒ Nëse $r=20\%$, për sa rritet oferta monetare kur depozitat rriten me 1,000?
- ⇒ Në cilat raste mund të mos rritet oferta monetare edhe kur kemi rritje të depozitave?